



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2362 / Prot.
7

Patos, më 09.10.2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 8 SHTATOR 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve, Njësia Administrative Ruzhdie

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjese publike me temë: “Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Kryetar i bashkisë z. Fation Duro, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, administrator i njësisë administrative Ruzhdie, rreth 18 pjesëmarrës (banorë, kryetarë të fshatrave, përfaqësues nga bizneset)

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba

Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Sekretare e Këshillit
znj. Refaela Xeba**

Dëgjese publike me temë:
“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, jemi këtu sot për të bërë një rishikim të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe për të rishikuar ndryshimet e Paketës Fiskale 2026. Ju ftoj të ndjekim prezantimin e ekzekutivit.

Drejtore i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj– përshëndetje të gjithëve! Lidhur me parashikimet në nivelin e taksave, parashikojmë që pjesa



**Drejtore
z. Çajup Refitaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të
projekt dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

e tarifave të mund të ndryshojë duke parë edhe variantet e ndryshme për një rritje të lehtë në mënyrë që të mos rëndohet popullata. Janë parë të gjithë elementët dhe bashkëpunimet me operatorët në mënyrë private. Po bëhet një rishikim i plotë i paketës. Edhe për pjesën e bizneseve po rigrupohen sepse po shikohen edhe natyrat e bizneseve dhe mbi bazën e llojit të aktivitetit do ndahen dhe tarifatat. Do shikohet dhe pjesa që kjo rritje mos të rëndojë edhe shumë. Për pjesën e tokës bujqësore dhe afatet që kemi përcaktuar po mendojmë që edhe për njësinë tuaj të jetë 31 gushti si afat. Do të ketë lehtësira në masën 15 apo 20% të detyrimit. Pra nëse do paguhet brenda kësaj periudhe do lehtësohet në këtë masë. Kërkohej një kontribut më i lartë në pjesën e taksave dhe tarifave.

Punonjës i njësive Ruzhdie, z. Xhemil Muçaj- përshëndetje! Te pjesa e tarifave të biznesit



**Punonjës i njësive Ruzhdie
z. Xhemil Muçaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

pse të mos tarifohen në bazë të xhiros? Sepse janë disa biznese që mezi mbijetojnë.

Kryetari i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Pjesa e tarifimit nuk mund të vendoset në bazë



**Kryetari i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

të xhiros që ka biznesi, por bëhet në bazë të mbetjeve që gjeneron ky biznes. Ndaj do rishikohet kjo pjesë në bazë të mbetjeve që bën biznesi.

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, z. Çajup Refitaj – tarifimi i bizneseve ka të bëjë me faktin e gjenerimit të mbetjeve. Kemi parasysh biznese që bëjnë pjesë të bizneset e mëdha. Mbi bazën e fitimeve dhe xhirove ndahen dhe bizneset, por duke parë natyrën dhe kostot shoqëruese është ndërë kostoja për disa operatorë të veçantë ndaj ne jemi të detyruar të bëjmë këtë grupim dhe të rishikojmë tarifat për bizneset.



**Drejtor
z. Çajup Refitaj
Dëgjesë publike me temë:**

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin
2026”
Shtator 2025**

Kryetar i fshatit Siqecë, z. Myftar Sorraj- përshëndetje! Fshati ynë nuk trajtohet me



**Kryetar i fshatit Siqecë
z. Myftar Sorraj
Dëgjesë publike me temë:**

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028
dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

shërbim për mbetjet. Ata hidhen vend e pa vend dhe nuk kemi kosha mbeturinash. Gjithashtu ndriçimi i fshatit është lënë gjysëm. Lagjja në Siqecë kërkon 5 panele diellor. Rruga Qafë Shkallëz ku është bërë një punë voluminoze është bërë një punë madhështore, por nëse nuk pastrohet kanali është e kotë. Për taskat jam dakord edhe për afatin e vendosur brenda 31 gushtit edhe pse ne kemi shumë të larguar nga fshati dhe është vështirë të mbledhësh taksat. Gjithashtu kemi nevojë edhe për disa tombino në fshat.

Kryetar i fshatit Gjynoqarë, Z. Nuri Gllava- në popullit për taksat nuk mund t'i themi mos i paguaj sepse përderisa po marrin shërbim nga bashkia dhe po punohet nuk mund të kundërshtojnë të bëjnë pagesën. Për sa i përket parcelës për Gjynoqarën bashkia po punon shumë dhe po hap dhe rrugë. Ne në fshat kemi nevojë për shtrimin e rrugës së fshatit dhe koshat.



**Kryetar i fshatit Gjynoqarë
z. Nuri Gllava**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

Administrator i njësisë administrative, z. Agim Mesutaj- Përshëndetje të gjithëve!



**Administrator i njësisë administrative
z. Agim Mesutaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

Faleminderit për angazhimet në njësinë Ruzhdie. Ne kemi ngritur në tre shtylla problemet që janë taksat, shërbimi social dhe konfliktet e ndryshme. Shërbimet gjatë rrugëve janë më shumë problem nga të gjithë. Sikur të ndihmoni pak me rërë bituminoze në rrugë pasi duhen karikuar gjithmonë. Taksat janë duke ecur me ritme të ngadalta te ne, por do përpiqemi.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Për pjesën e rrugës së Gjynoqarës do fillojnë me



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

muret dhe në përfundim të mureve do filloj dhe çakulli dhe asfalti. Muret do jenë me beton të gjithë. Për sa i përket kanaleve në rrugët bujqësore praktikisht e kemi të pamundur që ne të ndjekim hapjen e kanaleve me shpejtësi më shumë se kaq sa kemi bërë sepse janë shumë kanale dhe rrugë bujqësore. Kanalet do të vazhdojnë. Për ndriçimin Ruzhdia kishte shumë pak drita dhe janë vendosur 120 drita dhe do vazhdojnë të vendosen edhe të tjera. Në 2027 do përfundojnë dhe nuk do të keni më nevojë për drita. Rruga e Mekamit dhe Manxharaj janë futur për planifikim për nëdërhyrje. Plus janë dhe rrugët e tjera që kemi thënë. Janë edhe disa rrugë për tu bërë me çakëll dhe do sillen edhe tombinot për aty ku ka nevojë. Nëse nuk keni sugjerime të tjera dhe kërkesa do e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjesë publike.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba